REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës

Datë 5.10.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQEVE TË KËRKUARA NGA "OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST" SH.A QË PREKEN NGA PROJEKTI DHE NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 11, DATË 28.01.2025, PËR MIRATIMIN E "LEJE NDËRTIMI INFRASTRUKTURE PËR OBJEKTIN: NDËRTIMI I LINJËS 110 KV GJIRI I LALËZIT – FUSH KUQE DHE SHTESA E NËNSTACIONIT 110 KV FUSH KUQE".**

Baza ligjore:

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar, VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-së nr.134 datë 03.03.2021 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listave të inventarit,dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive", Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore" i ndryshuar, Vendimit Nr. 11, datë 28.01.2025 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), është miratuar leja e ndërtimit të infrastrukturës për projektin energjetik "Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë-Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë-Kuqe", kërkesës së ardhur nga subjekti OST Sh.A me anë të sistemit ALFIS me numër aplikimi MJEDISI-2026-751611-IU, Urdhërit nr. 238, datë 16.06.2026, të Kryetares së Bashkisë Durrës, për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore/kullosore, që propozohen të hiqen dhe të jepen në përdorim "Për ndërtim/përdorim rrugë kalimi dhe shesh ndërtimi për bazamentin e shtyllave të tensionit 110 kV".

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor publik të sipërfaqes prej 0.034 ha, për bazamentin e shtyllave të tensionit 110 kV, në Ekonomitë Pyjore "Kuratën" dhe "Kodër Rekë", Bashkia Durrës, në funksion të ndërtimit të linjës së tensionit 110 kV, sipas dokumentacionit tekniko-ekonomik që i bashkëlidhen këtij vendimi, në zbatim të legjslacionit në fuqi, me përcaktimet si më poshtë në Ekonomitë Pyjore:

   - Ekonominë Pyjore "Kuratën":

   a. Nëngastrat 21, 25, 26, 18b, 17a, 13a, 9 dhe 8; Zona Kadastrale 2332; Kodi Kadastral DR11 00 021, DR11 00 025, DR11 00 026, DR11 00 018b, DR11 00 017a, DR11 00 013a, DR11 00 009 dhe DR11 00 008;

   b. Nëngastra 47a - Zona Kadastrale 2375. Kodi Kadastral DR11 00 047a.

   - Ekonominë Pyjore "Kodër Rekë":

   a. Nëngastrat 22a, 25c, 26d, 27c dhe 32a; Zona Kadastrale 2543; Kodi Kadastral DR08 00 022a, DR08 00 025c, DR08 00 026d, DR08 00 027c dhe DR08 00 032a.

2. Dhënia në përdorim për sipërfaqjen prej 0.18 ha për përdorim rruge kalimi, si dhe për sipërfaqjen prej 4.126 ha e linjës së tensionit 110 kV të bëhet për një periudhë 1 (një) vjeçare.

3. Subjekti OST Sh.A. detyrohet të paguajë vlerën totale prej 405,732 (katërqind e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë, sipas përcaktimeve të raportit tekniko-ekonomik dhe legjislacionit në fuqi.

4. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

-

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: *(PO/JO)*

Po. Është zhvilluar Konsultim tek salla e këshillit me datë 14.09.2026

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, u mblodhë më datë 5.10.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 2 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Komisioni i Zhvillimit Urban u mblodh për të diskutuar për pikën 2. Pas diskutimeve ne si komision jemi dakort që të kalojmë këtë pikë.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- _____

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës

Kryetar	Jonada Mamo	RPO
Zv/Kryetar	Ardian Muka	
Sekretar	Franc Tragaj	
Anëtar	Munir Konesha	

Anëtar	Denis Lika
Anëtar	Sami Osmani
Anëtar	Renald Koka
Anëtar	Anisa Ibraj
Anëtar	Kastriot Xhongoli